



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

K.DH.SH.II.nr.1103/22

GJYKATA KOMERCIALE NË PRISHTINË-Dhoma e Shkallës së Dytë, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Krenar Berisha, kryetar i kolegjit, Saranda Bogaj Sheremeti dhe Franciska Zhitija Ymeri, anëtare të kolegjit, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit N.T.P. L... me seli në Ferizaj, te cilin e përfaqëson Kushtrim Bytyqi avokat nga Prishtina kundër të paditurës Dogana e Kosovës në Prishtinë, me bazë juridike, anulim vendimi, duke vendosur lidhur me ankesën e paditurës të ushtruar kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, Divizioni Fiskal, A.nr.514/2020 të datës 14.02.2022, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 27.10.2022, merr këtë:

A K T G J Y K I M

Aprovohet si e bazuar ankesa e të paditurës Dogana e Kosovës në Prishtinë, ndërsa Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Administrative-Divizioni Fiskal, A.nr.514/2020 të datës 14.02.2022, Prishtet, dhe lënda i kthehet Dhomës së Shkallës së Parë-Departamenti Fiskal i Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në rigjykim dhe rivendosje.

A R S Y E T I M

Me aktgjykimin e ankimuar të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, Divizioni Fiskal, në pikën I të dispozitivit ka vendosur: Aprovohet si e bazuar Kërkesëpapia e paditësit N.T.P. L... me seli në Ferizaj, Rr. “.....”. nën pikën II. Anulohet aktvendimi nr.01.3.2.2/17992 i datës 17.01.2020 i Doganës së Kosovës. nën pikën III. Obligohet e paditura Dogana e Kosovës, që paditësit N.T.P. L... me seli në Ferizaj, Rr. “.....”, t’ia kthej shumën prej 250€ (dyqind e pesëdhjetë euro) si dhe shumën 579.03€ (pesëqind e shtatëdhjetë e nëntë euro e tre cent), të paguara nga paditësi në emër të gjobës dhe taksës doganore, për shkak të ndryshimit të kodit tarifor për mallin lëndor të zhdoganuar me Deklaratën Unike Doganore me nr. R-77817/07.12.2019, me kamatë ligjore prej 8% duke filluar nga data 18.12.2019, kur paditësi ka ushtruar ankesë tek e paditura, e deri në pagesën e plotë të kësaj shume, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi. nën pikën IV. Ky aktgjykim e zëvendëson aktvendimin nr. 01.3.2.2/17992 të datës 17.01.2020 të Doganës së Kosovës në Prishtinë. Në pikën V. Secila palë ndërgjyqëse i bartë shpenzimet e veta procedural.

Kundër këtij aktgjykimi në afat ligjor ankesë ka ushtruar e paditura me të cilin e konteston ligjshmërinë e të njëjtit, për shkak të; zbatimit të gabuar të drejtës material, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe shkelje esenciale të dispozitave të procedurës LKA-së, me propozim që të aprovon ankesën në tërësi si të bazuar në ligj, të prish Aktgjykimin A.nr.514/2020 i datës 14.02.2022 si të pa bazuar në ligj, ta refuzon padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit në tërësi si të pa bazuar me ligj dhe ta lë në fuqi aktvendimin e kontestuar, ose t'ia kthej gjykatës në rishqyrtim dhe rivendosje. Gjykata e shkallës së parë ka bërë shkelje esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore nga fakti se në arsyetim të aktgjykimit nuk i ka theksuar faktet vendimtare, Aktgjykimi me të cilin është aprovuar kërkesëpadia e paditësit përmban edhe konstatim të gabuar të gjendjes faktike dhe aplikim të gabuar të drejtës materiale. Gjykata gabimisht konstaton se në rastin konkret ka bazë ligjore për t'iu referuar faturës/2019 dhe deklaratës eksportuese si dokumente të sakta për përcaktimin e numrit tarifor 85381000 për mallin lëndor. Dogana e Kosovës vendimin e saj e ka mbështetur në Mendimin për klasifikim tarifor sipas të cilit malli i përshtatet kodit tarifor 8536901000. Konstatimi i gjykatës është në kundërshtim me dispozitat ligjore sepse në bazë të dispozitave të Kodit Doganor, detyrimet e importit për tu paguar ligjërisht kur lind një borxh doganor bazohen në nomenklaturën e mallrave të TARIK-ut të Tarifës doganore të Kosovës, ligjeve të zbatueshme dhe çdo marrëveshje me një vend tjetër, kur merren masa për lejimin e trajtimit preferencial tarifor.

Në shkresat e lëndës nuk ka përgjigje në ankes

Kolegji i Dhomës së Shkallës së Dytë, vlerësoi ligjshmërinë e aktgjykimit të ankimuar, si në vështrim të nenit 12 të Ligjit 08/L-015 dhe nenit 194 i LPK-së, në drejtim të theksimeve në ankesë dhe pas shqyrtimit edhe të shkresave tjera të lëndës gjen se:

Ankesa është e bazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se e paditura me aktvendimin nr. 01.3.2.2/17992 të datës 17.01.2020, e ka refuzuar kërkesën e subjektit në procedurë N.T.P. L... me seli në Ferizaj, për rishqyrtimin e vendimit numër 03.1.7-2019-1800/2 të datës 10.12.2019 të lëshuar nga Sektori për Kundërvajtje Doganore, si e pa bazë. Paditësi, i pa kënaqur me vendimin e lartcekur ka ushtruar padi në konflikt administrativ kundër të paditurës Dogana e Kosovës në Prishtinë, me të cilën e konteston ligjshmërinë e vendimit të saj dhe kërkon që i njëjti të anulohet si jo ligjor.

Gjykata e shkallës së parë, pas shqyrtimit të padisë së paditësit paraqitur kundër vendimit të lartcekur, si dhe pas administrimit të provave si në procesverbal të seancës së shqyrtimit kryesor datës 14.02.2022, e duke u bazuar edhe në provat dhe dëshmitë e tjera të lëndës bie Aktgjykimin e ankimuar me të cilin e ka aprovuar si të bazuar kërkesëpadinë e paditësit N.T.P. L... me seli në Ferizaj, ka anuluar Aktvendimin nr.01.3.2.2/17992 i datës 17.01.2020 i Doganës së Kosovës dhe ka obliguar të paditurën Dogana e Kosovës, që paditësit N.T.P. L... me seli në Ferizaj, Rr. ".....", t'ia kthej shumën prej 250€ (dyqind e pesëdhjetë euro) si dhe shumën 579.03€ (pesëqind e shtatëdhjetë e nëntë euro e tre cent), të paguara nga paditësi në emër të gjobës dhe taksës doganore, për shkak të ndryshimit të kodit tarifor për mallin lëndor të zhdoganuar me Deklaratën Unike Doganore me nr. R-77817/07.12.2019, me kamatë ligjore prej 8% duke filluar nga data

18.12.2019, kur paditësi ka ushtruar ankesë tek e paditura, e deri në pagesën e plotë të kësaj shume, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi. Në arsyetim të aktgjykimit, jepen vlerësimet faktike dhe juridike të gjykatës, se e paditura kundërligjshëm e ka ndryshuar kodin tarifor për mallin e zhdoganuar nga paditësi përmes DUD-it/2019 me kod tarifor 85381000 ashtu që malli sipas këtij kodi tarifor lirohet nga pagesa e taksës doganore, bazuar në nomenklaturën e mallrave ligjërisht të detyrueshme në Kosovë, në kodin tarifor 8536901000 sipas të cilit kod paditësi është obliguar të paguaj taksën doganore prej 8%. Paditësi ka paraqit dokumentacion relevant për të mbështetur deklarinimin e kodit tarifor, respektivisht ka paraqit faturën e blerjes së mallit, dt.02.12.2019 e lëshuar nga eksportuesi i mallit, ku është shënuar numri tarifor ashtu siç është deklaruar, po ashtu deklarata eksportuese e lëshuar nga shteti eksportues Turqi dt.01.12.2019 ku përsëri numri tarifor është shënuar 85381000, numër ky i deklaruar nga paditësi me DUD-in Mendimin për klasifikim tarifor 04.1.2 nr.153 dt.10.12.2019 i nxjerr nga Sektori i Tarifës, gjykata e shkallës së parë e konsideron si provë i nxjerr në kundërshtim me rregullat e procedurës administrative, sepse as e paditura nuk është e sigurt për klasifikimin tarifor të mallit dhe nuk paraqet provë të re në kuptim të nenit 72.b dhe 265.1 e Kodit Doganor dhe të Akcizave 03/L-109.

Kolegji i Dhomës së Shkallës së Dytë, duke u nisur nga një gjendje e tillë e çështjes dhe duke shqyrtuar vendimet e organit të paditur, aktgjykimin e ankimuar të gjykatës së shkallës së parë, si dhe shkresat e tjera të lëndës, gjen se aktgjykimi i ankimuar është i përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 183, dhe zbatim i gabuar i të drejtës materiale nga neni 184 i LPK-së, dhe si tillë është jo i plotë.

Kolegji, i shqyrtoi me kujdes shkresat e lëndës, dhe erdhi në përfundim se gjykata e shkallës së parë vendimin e saj e ka nxjerr duke mos e zbatuar në mënyrë të drejtë dispozitën ligjore nga neni 183 të LPK-së, me të cilën përcaktohet se: Ekziston vërtetimi i gabuar apo jo i plotë i gjendjes faktike kur gjykata gabimisht e ka vërtetuar ndonjë fakt vendimtar, përkatësisht kur faktin e tillë nuk e ka vërtetuar fare. Në rastin konkret gjykata e shkallës së parë gjendjen faktike nga dokumentacioni i lëndës, ka marrë për bazë faturën e mallit doganor date 02.12.2019 dhe deklaratën e shtetit eksportues Turqi, si prova vendimtare që mbështesin konkludimin se malli lëndor është deklaruar saktë me kodin tarifor 85381000 sipas Deklaratës Unike Doganore R-..... Gjithashtu Kolegji gjen se gjykata e shkallës së parë zbaton në mënyrë jo të drejtë dispozitat ligjore që bie ndesh me nenin 184 të LPK-së ku përcaktohet se: Zbatimi i gabueshëm i së drejtës materiale ekziston kur gjykata nuk e ka zbatuar dispozitën e së drejtës materiale që është dashur ta zbatojë, apo kur dispozitën e tillë nuk e ka zbatuar në mënyrë të drejtë. Kjo për arsye se nuk gjen zbatim neni 72,b dhe neni 265.1 (a,b,c) të Kodit Doganor dhe të Akcizave 03/L-109, për të vërtetuar drejt klasifikimin tarifor të një malli doganor që paraqitet pranë autoriteteve doganore. Kolegji, nga shkresat e lëndës nuk ka gjetur se paditësi ka paraqit para të paditurës dhe gjykatës, dokumente që kërkohen për aplikimin e aranzhimeve tarifore, ndërsa fatura përcjellëse e mallit lëndor dhe deklarata e shtetit eksportues, nuk janë dokumentacione që kërkohen për të vërtetuar drejt klasifikimin tarifor të një malli doganor.

Në rastet e tilla kur ngritet dilema e përcaktimit të drejtë të klasifikimit tarifor të një malli doganor, Kolegji vlerëson se e paditura Dogana e Kosovës në Prishtinë ka autorizime ligjore nga neni 18 të Kodit Doganor dhe të Akcizave të Kosovës 03/L-109, të lëshoj informacion të detyrueshëm tarifor. Në rastin konkret e paditura Sektori i Tarifës me kërkesë të ZBD Prishtinë, ka nxjerr

Mendim për Klasifikim Tarifor 04.1.2 nr.153/10.12.2019 dt.10.12.2019, duke bërë klasifikimin tarifor 8536901000 dhe përshkrimin e duhur të deklarimit të produktit, bazuar në TARIK-2019, fotove të mallit, informatave nga interneti, klasifikimit nga vendet e unionit evropian, informatat nga ueb faqja e prodhuesit. Andaj, sipas Kolegjit të Dhomës së Shkallës së Dytë, gjykata e shkallës së parë ka pasur obligim të shqyrtoj me kujdes dispozitat e legjislacionit doganor, si dhe të gjitha provat e administruara që ka ofruar paditësi para gjykatës dhe paditurës, ashtu që barra e provave për ta dëshmuar të kundërtën e Mendimit për klasifikim tarifor 04.1.2 nr.153/10.12.2019 dt.10.12.2019, në këtë rast bie mbi paditësin, për të dëshmuar klasifikimin e drejt tarifor, veprim ky që parashihet me nenin 81.F paragrafi 1 të Ligjit 04/L-102 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit 03/L-222 për Administratën Tatimore dhe Procedurat.

Për arsyet e dhëna më lartë, aktgjykimi i kundërshtuar është dashur të priset, dhe çështja ti kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim, për ti mënjanuar shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 183, 184 të LPK-së, që janë të atilla që pengojnë vlerësimin e ligjshmëris së aktgjykimit të goditur. Në ri procedurë gjykata e shkallës së parë, duhet ti shqyrtojë të gjitha vërejtjet e dhëna nga Kolegji i kësaj gjykate, të shqyrtoj me kujdes dispozitat e legjislacionit doganor, respektivisht shtojcën e Udhëzimit Administrativ 39/2017, e cekur si në arsyetimin e vendimit të organit të paditur, si dhe provat që janë nxjerr gjatë procedurës administrative, ashtu që me rastin e vendim marrjes, ku e paditura e ka bërë përgjegjës paditësin për mos deklarim të saktë të kodit tarifor të mallit doganor për Deklaratën Unike Doganore , të vërtetohen informatat detyruese tarifore të konfirmuara nga autoritetet doganore të shtetit eksportues dhe të autoriteteve doganore të Republikës së Kosovës, që kanë paraqit apo mund të kenë siguruar palët ndërgjyqëse në konflikt administrativ, e të cilat informata tarifore janë të vlefshme vetëm për periudhën kur është deklaruar për zhdoganim malli kontestues. Këto informata detyruese tarifore janë dokumente që shërbejnë për aplikim të aranzhimeve preferenciale tarifore, dhe të njëjtat janë dokumente të kërkuara ligjërisht nga neni 123 paragrafi 1 pika (c) e Udhëzimit Administrativ nr.11/2009 për Implementimin e Kodit Doganor dhe të Akcizave dhe neni 18 i Kodit Doganor dhe të Akcizave të Kosovës 03/L109

Mbi këtë bazë e në mbështetje të nenit 12 të Ligjit 08/L-015, lidhur me nenin 200 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA KOMERCIALE PRISHTINË
Dhoma e Shkallës së Dytë
K.DH.SH.II.nr.1103/22 me datë 27.10.2022

Kryetar i kolegjit,
Krenar Berisha